



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____ / 2018

PËR
NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9426, DATË 06. 10. 2005 “PËR MBARËSHTIMIN E
BLEGTORISË”, I NDRYSHUAR,

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin Nr. 9426, datë 06. 10. 2005 “Për mbarëshkrimin e blegtorisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 53, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 53

1. Veprimtaria e ndërzimit natyror ushtrohet në mënyrë të lirë nga stacioni i ndërzimit natyror, nëse ai plotëson kriteret për personelin teknik, pajisjet, mjetet dhe riprodhuesit meshkuj.”.
2. Kushtet e hollësishme teknike për ushtrimin e veprimtarisë në stacionet e ndërzimit natyror miratohen me udhëzim nga ministri që mbulon çështjet e bujqësisë dhe të blegtorisë.
3. Subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e ndërzimit natyror duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e kësaj veprimtarie.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI